



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P 217/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 12.05.2021 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës ekonomike “Silver” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr. REF-87331-02-16-2021 me objekt Loti 7 “*Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Repartin Ushtarak nr. 1010*”, Vau i Dejës-Shkodër, me fond të marrëveshjes kuadër: 18,175,160 (tetëmbëdhjetë milion e njëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë) Lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 18.03.2021 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

Ankimues: “Silver” SHPK
Adresa: Njësia Bashkiake Nr.5, Rruga “Bajram Curri”, Pallatet 1 Maj, godina 7, shkalla 4, kati1, Tiranë

Autoriteti kontraktor: Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.
Adresa: Sheshi Skënderbej Nr. 3, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin*

dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, neni 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.3. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 17.02.2021, në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr. REF-87331-02-16-2021 me objekt Loti 7 “*Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Repartin Ushtarak nr. 1010*”, Vau i Dejës-Shkodër, me fond të marrëveshjes kuadër: 18,175,160 (tetëmbëdhjetë milion e njëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e

njëqind e gjashtëdhjetë) Lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 18.03.2021 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

II.2. Në datën 16.03.2021 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 31.03.2021 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezultoi si më poshtë vijon:

Silver	15,595,560 leke	S'kualifikuar
Nika	15,616,974 leke	kualifikuar
Gustoso	16,341,060 leke	kualifikuar
Dion-Al	16,848,360 leke	S'kualifikuar
Lartist	17,958,792 leke	S'kualifikuar
Hotel Comfort	17,993,490 leke	S'kualifikuar

II. 4 Në datën 06.04.2021 operatori ekonomik "Silver" SHPK ka paraqitur ankesën pranë autoritetit kontraktor për kualifikimin e ofertes se tij në mënyrë të përmbledhur me argumentet si më poshtë:

Në datë 31.03.2021 Autoriteti Kontraktor Agjencia e Blerjeve të Përqendruara publikoi në sistemin e Agjencisë së Prokurimeve Publike njoftimin e klasifikimit për procedurën me objekt Loti 7 "Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Repartin Ushtarak nr. 1010", Vau i Dejës-Shkodër, me fond të marrëveshjes kuadër: 18,175,160 (tetëmbëdhjetë milion e njëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë) Lekë (pa TVSH), ku rezultoi që oferta jonë është skualifikuar. Oferta jone është skualifikuar me pretendimin se: Ofertuesi nuk plotëson pikën 1, seksioni 3.2, Kapaciteti ekonomik dhe financiar i Kriterëve të veçanta të kualifikimit, pasi në momentin e hapjes së ofertave, nuk arriti të provojë se ka kapacitete ekonomike financiare sa shuma e loteve 1 dhe 7 për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Nga dokumentacioni i paraqitur në SPE, rezultoi se mesatarja e xhiros së realizuar për periudhën e kërkuar është me e vogël se 40% e vlerës së shumës së fondeve limit (loti 1 dhe 7) për të cilat ka ofertuar.

Ankesa jonë bazohet në nenin 63, pika 1, i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", I ndryshuar, parashikon se: "Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim / autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.

1. Referuar pretendimit se operatori ekonomik Silver SHPK nuk plotëson nenin 1, të seksionit 3.2 „Kapaciteti ekonomik dhe financiar të Kriterëve të veçanta të kualifikimit, pasi në momentin e hapjes së ofertave nuk arriti të provojë se ka kapacitete ekonomike financiare sa shuma e loteve 1 dhe 7 për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku pasi nga dokumentacioni i paraqitur në SPE, rezultoi se mesatarja e xhiros së realizuar për periudhën e kërkuar është më e vogël se 40% e

vlerës së shumës së fondeve limit (loti 1 dhe loti 7) për të cilët ka ofertuar dhe për këtë arsye është skualifikuar nuk qëndron dhe si me poshtë po ju shpjegojme:

Në dokumentacionin e paraqitur në SPE nga operatori ekonomik mesatarja e xhiros së 3 viteve të fundit(2018,2019,2020) është 17,023,629(shtatëmbëdhjetë milion e njëzet e tre mijë e gjashtëqind e njëzet e nëntë) Lekë pasi shuma totale e xhiros vjetore e 3 viteve te fundit është 51,070,887(pesëdhjetë e një milion e shtatëdhjetë mijë e tetëqind e tetëdhjetë shtatë)Lekë.

Pra pjesëtimi i shumës totale të xhiros vjetore të 3 viteve të fundit me numrin 3 na nxjerr rezultatin 17,023,629(shtatëmbëdhjetë milion e njëzet e tre mijë e gjashtëqind e njëzet e nëntë)Lekë Shuma e vlerës së fondeve limit të lotit 1(23,283,310) dhe lotit 7(18,175,160) është 41,458,470(dyzet milion e katërqind e pesëdhjetë e tetë mijë e katërqind e shtatëdhjetë)Lekë dhe rrjedhimisht 40% e kësaj vlere totale të fondeve limit të loti 1 dhe loti 7 del në vlerën 16,583,388(gjashtëmbëdhjetë milion e pesëqind e tetëdhjetë e tre mijë e treqind e tetëdhjetë e tetë)Lekë.

Pra sipas përlllogaritjeve të bëra nga ne dhe lehtësisht të verifikueshme nga ana juaj rezulton që mesatarja e xhiros së 3 viteve të fundit është më e madhe se 40% e vlerës së shumës së fondeve limit (loti 1 dhe loti 7) për të cilët kemi ofertuar (17,023,629 > 16,583,388)

Për autoritetin kontraktor është e domosdoshme dhe e rëndësishme të vërtetohet që një operator ekonomik plotëson kriteret e kërkuara, për sa kohë ato janë në përputhje dhe në përpjesëtim me përmasat dhe natyrën e objektit që prokurohet.

Referuar Nenit 55 të Ligjit 9643, date 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", I ndryshuar, parashikohet: I. "Oferta fituese duhet të jetë: a) oferta që në bazë të kërkesave dhe kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit, plotëson kërkesat e objektit të prokurimit me çmimin më të ulët. 2. Autoriteti Kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar, ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit.

Për sa më sipër, Autoriteti Kontraktor duhet të vlerësonte dokumentacionin e paraqitur në SPE, referuar pajtueshërisë së tyre me çdo kriter kualifikimi, të parashikuar në dokumentet standarde të tenderit.

Referuar legjislacionit në fuqi për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës në respekt të nenit 46 pika 1 gërma "b", të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar.

Akoma më tej sqarojmë se në bazë të nenit 62 "Detyrimet gjatë zbatimit të kontratës" të LPP, autoriteti kontraktor ka një rol të posaçëm, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës dhe është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t'u siguruar nëse cilësia e mallit apo shërbimit do të jetë e njëjtë me cilësinë dhe specifikimet teknike të premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë. Në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara, autoriteti kontraktor zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë, apo detyrimet, në mbështetje të nenit 62 të LPP-s\

Sa më sipër, autoriteti kontraktor, duhet të udhëhiqet nga parimi i mirëpërdorimit të fondeve publike dhe përfitimi i një shërbimi me cilësi të mire dhe me çmim të ulët, si edhe nuk duhet të

gjykojë në mënyrë sipërfaqësore e formale, aq më tepër në kushte kur kemi një paraqitje të sakte dokumentacionit që duhet të paraqitet,

Për sa më lart sqaruar, Operatori ekonomik Silver SHPK ka dorëzuar të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve para hapjes së ofertave dhe rrjedhimisht duhet të kualifikohet si oferte e suksesshme.

Duke mirëkuptuar dhe shpresuar në një gabim aritmetik dhe njerezor nga ana juaj, ne pritje të një vlerësimi tjetër të dokumenteve dhe fakteve.

Për sa më sipër argumentuam, në zbatim të kërkesave të Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin publik", të ndryshuar. VKM Nr.974, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" dhe DST, kërkojmë:

• Kualifikimin e ofertës së shoqërisë sonë si ofertë që i përmbush të gjitha kriteret të parashikuara në dokumentet e tenderit

II.5. Në datën 12.04.2021 autoriteti kontraktor ka kthyer përgjigje në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik duke mos e pranuar atë me arsyetimin si më poshtë: *Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pasi verifikoi dokumentet e tenderit, vlerësimin e bërë në sistemin e prokurimit elektronik dhe procesverbalin e mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit të*

Ofertave, dokumentet e dorëzuara nga ofertuesi, pretendimet e parashtruara në ankesë mbi skualifikimin e ofertës së tij konstatoi se:

Për ofertuesin "Silver" SHPK, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka njoftuar dhe dhënë automatikisht nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik më datë 31.03.2021 arsyet e skualifikimit të ofertës së tij si vijon: "Ofertuesi nuk plotëson pikën 1, seksioni 3.2, Kapaciteti ekonomik dhe financiar të Kriterëve të veçanta të kualifikimit, pasi në momentin e hapjes së ofertave, nuk arriti të provojë se ka kapacitete ekonomike financiare sa shuma e loteve 1 dhe 7 për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Nga dokumentacioni i paraqitur në SPE, rezultoi se mesatarja e xhiros së realizuar për periudhën e kërkuar është më e vogël se 40% e vlerës së shumës së fondeve limit (loti 1 dhe 7) për të cilat ka ofertuar."

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, verifikoi në sistemin e prokurimit elektronik dokumentacionin e paraqitur si pjesë e ofertës ekonomike nga Ofertuesi "Silver" SHPK e konstatoi:

Në dokumentet e tenderit në shtojcën nr. 8 "Kriteret e veçanta të kualifikimit" në seksionin 3.2 "Kapaciteti ekonomik dhe financiar" pika 1 përcaktohet se kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë kopje të deklaratave të xhiros vjetore ose vërtetim nga administrata tatimore, për xhiron e realizuar në tre vitet e fundit 2017, 2018, 2019, vlera mesatare e të cilës të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të lotit."

Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik rezultoi se ofertuesi ka paraqitur dokumentacionin me emërtim "Vërtetim xhiro Loti 7". Vërtetimi është lëshuar për periudhën tatimore 18-A, 19-A, 20-A. Gjithashtu ofertuesi ka dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik "Deklaratën për pjesëmarrjen në më shumë se një lot", ku ka deklaruar se "... Kemi kapacitete ekonomike-financiare (nënpika 1 e seksionit 3.2, të kriterëve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitete teknike (nënpikat 1, 3 dhe 4 të seksionit 3.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim), për Pjesëmarrjen tonë 100% në Lotin 7 "Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Repartin Ushtarak nr. 1010", Vau i Dejës-Shkodër. " në dhe për Pjesëmarrjen tonë 100% në Lotin I "Shërbim gatimi dine shpërndarje ushqimi për Repartin Ushtarak nr. 6630."

Në dokumentet e tenderit në shtojcën nr. 8 "Kriteret e veçanta të kualifikimit" është bërë shënimi: Shënim: Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike - financiare (nënpika 1 e seksionit 3.2, të kriterëve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetet teknike (nënpikat 1, 3 dhe 4 të seksionit 3.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Në këtë rast, operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të paraqesë një deklaratë ku të listohen dokumentet e paraqitura në përmbushje të kriterëve kumulative për Lotin konkret. Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kriterëve kumulative nuk plotëson kapacitetet ekonomike - financiare dhe kapacitetet teknike për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, do të skualifikohet nga të gjitha Lotet ku ka ofertuar.

Nga verifikimi i dokumenteve të dorëzuara në sistemin e prokurimit elektronik, rezulton se ofertuesi "Silver" SHPK ka ofertuar për Lotin I "Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Repartin Ushtarak nr. 6630" dhe Lotin 7 "Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Repartin Ushtarak nr. 1010", Vau i Dejës-Shkodër." Gjithashtu nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar për përmbushjen e pikës 1 në seksionin 3.2 "Kapaciteti ekonomiko-financiare" dhe shënimin për përmbushje të kriterëve kumulative për Lotin konkret, rezulton se ofertuesi nuk e ka plotësuar kriterin.

Në lidhje me pretendimet e ofertuesit "...Në dokumentacionin e paraqitur në SPE nga operatori ekonomik mesatarja e xhiros së 3 viteve të fundit(2018,2019,2020) është 17,023,629...", sqarojmë se kriteri në dokumentet e tenderit është përcaktuar për xhiron e realizuar në tre vitet e fundit 2017, 2018, 2019, vlera mesatare e të cilës të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të lotit.

Sa më sipër në zbatimin të Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar nenin 53 pika 3 ku përcaktohet se: "Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji", dhe shënimin në dokumentet e tenderit ku përcaktohet se ".... Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kriterëve kumulative nuk plotëson kapacitetet ekonomike - financiare dhe kapacitetet teknike për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, do të skualifikohet nga të gjitha Lotet ku ka ofertuar," është bërë skualifikimi i ofertuesit "Silver" SHPK.

Për arsyet e më sipërme pretendimi i ofertuesit "Silver" SHPK nuk pranohet.

II.6. Në datën 16.04.2021 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese drejtuar autoritetit kontraktor.

1. Referuar pretendimit se operatori ekonomik Silver SHPK nuk plotëson nenpikën 1, të seksionit 3.2 „Kapaciteti ekonomik dhe financiar të kriterëve të veçanta të kualifikimit, pasi në momentin e hapjes së ofertave nuk arriti të provojë se ka kapacitete ekonomike financiare sa shuma e loteve 1 dhe 7 për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku pasi nga dokumentacioni i paraqitur në SPE, rezulton se mesatarja e xhiros së realizuar për periudhën e kërkuar është me e vogël se 40% e vlerës së shumës së fondeve limit (loti 1 dhe loti 7) për të cilat ka ofertuar dhe për këtë arsye është skualifikuar nuk qendron dhe si me poshtë po ju shpjegojmë:

1.1 Ne date 16/02/2021 Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara ka shpallur te hapur procedurën e prokurimit: "Procedurë e hapur -Shërbime"-Marrëveshje Kuadër, me afat 2(dy)vite nga nënshkrimi i marrëveshjes kuadër, me disa operatorë ekonomike ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me objekt : "Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për strukturat ushtarake të Forcave të Armatosura" i ndarë në 8(tetë) Lote , me fond të marrëveshjes kuadër 140,806,469 Leke (pa TVSH), me REF-87336-02-16-2021.

1.2 Operatori ekonomik Silver SHPK ka dërguar ankesë që mban Nr. Prot 13 me datë 18/02/2021 pranë APP-se per modifikimin e kriterëve dhe shprehimisht ne ankese thuhej:

Në DST dhe konkretisht në kriteret e Vecanta për Kualifikim, seksioni 3.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar, pika 1, kërkohet:

-Kopje të deklaratave të xhiros vjetore ose vërtetim nga administrata tatimore, për xhiron e realizuar në tre vitet e fundit 2017, 2018, 2019, vlera mesatare e të cilës të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të lotit.

Shoqëria SILVER SHPK ka bërë deklarinimin e pasqyrave financiare dhe xhiros për vitin 2020, kështu që rrjedhimisht Sistemi i gjeneron dokumentin VERTETIM (Per Xhiron e Tre Viteve te fundit) në të cilin pasqyrohet xhiroja e viteve 2018,2019,2020.Ky dokument gjenerohet automatikisht pa mundur të bëjmë përzgjedhje për kë vit financiar duam Vertetim për xhiro, pasi Opsioni është:" Vertetim Per Xhiron e Tre Viteve te fundit".

Do ju luteshim të rishikonit ,ndryshonit apo modifikonit pikën 1 të seksionit 3.2 të Kriterëve të vecanta për kualifikim, pa specifikuar kush janë 3 vitet e fundit pasi në rastin tonë sistemi gjeneron vitin 2020 dhe jo atë 2017.

1.3 Në date 24/02/2021 me shkresën qe mban Nr. Prot. 442/2 dërguar drejt nesh nga Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave pranë AK-se jemi informuar që Pretendimi i ankimuesit Silver SHPK Pranohet dhe se kriteri i sipërcituar do të modifikohet si vijon:

Kopje të deklaratave të xhiros vjetore ose vërtetim nga administrata tatimore, për xhiron e realizuar në tre vitet e fundit financiare(2018,2019,2020),vlera e të cilës të jete jo me e vogël se 40% e vlerës së fondit limit.

Duke u nisur nga ky fakt Operatori ekonomik Silver SHPK vijoi në përgatitjen e dokumentacionit për pjesëmarrje në këtë procedurë duke dorëzuar të gjithë dokumentacionin e duhur në afatin e përcaktuar.

1.4 Në datë 31.03.2021 Autoriteti Kontraktor Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara publikoi në sistemin e Agjencisë së Prokurimeve Publike njoftimin e klasifikimit për procedurën me objekt Loti 7 "Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Repartin Ushtarak nr. 1010", Vau i Dejës-Shkodër, me fond të marrëveshjes kuadër: 18,175,160 (tetëmbëdhjetë milion e njëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë) Lekë (pa TVSH), ku rezulton që oferta jonë është skualifikuar me pretendimin:

Operatori ekonomik Silver SHPK nuk plotëson nenpikën 1, të seksionit 3.2 ,Kapaciteti ekonomik dhe financiar te Kriterëve te vecanta te kualifikimit, pasi në momentin e hapjes së ofertave nuk arriti të provojë se ka kapacitete ekonomike financiare sa shumta e loteve 1 dhe 7 për te cilat ka ofertuar, të marra së bashku pasi nga dokumentacioni i paraqitur në SPE, rezulton se mesatarja

e xhiros së realizuar për periudhën e kërkuar është me e vogël se 40% e vlerës së shumës së fondeve limit (loti 1 dhe loti 7) për të cilët ka ofertuar.

1.5 Operatori ekonomik Silver SHPK ka dërguar ankesë që mban Nr.Prot 22 me datë 02/04/2021 pranë ABP-se me ane të cilës sqarojmë shprehimisht si më poshtë:

Në dokumentacionin e paraqitur në SPE nga operatori ekonomik mesatarja e xhiros së 3 viteve të fundit (2018,2019,2020) është 17,023,629 (shtatëmbëdhjetë milion e njëzet e tre mijë e gjashtëqind e njëzet e nëntë) Leke pasi shuma totale e xhiros vjetore e 3 viteve të fundit është 51,070,887 (pesëdhjetë e një milion e shtatëdhjetë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e shtatë) Lekë.

Pra pjesëtimi i shumës totale të xhiros vjetore të 3 viteve të fundit me numrin 3 na nxjerr rezultatin 17,023,629 (shtatëmbëdhjetë milion e njëzet e tre mijë e gjashtëqind e njëzet e nëntë) Lekë.

Shuma e vlerës së fondeve limit të lotit 1 (23,283,310) dhe lotit 7 (18,175,160) është 41,458,470 (dyzet milion e katërqind e pesëdhjetë e tetë mijë e katërqind e shtatëdhjetë) Lekë dhe rrjedhimisht 40% e kësaj vlere totale të fondeve limit të loti 1 dhe loti 7 del në vlerën 16,583,388 (gjashtëmbëdhjetë milion e pesëqind e tetëdhjetë e tre mijë e treqind e tetëdhjetë e tetë) Lekë.

Pra sipas përlllogaritjeve të bëra nga ne dhe lehtësisht të verifikueshme nga ana juaj rezultojnë që mesatarja e xhiros së 3 viteve të fundit është më e madhe se 40% e vlerës së shumës së fondeve limit (loti 1 dhe loti 7) për të cilët kemi ofertuar (17,023,629 > 16,583,388)

Pra i jemi përgjigjur ekzaktesisht arsyetimit të skualifikimit të paraqitur nga ABP në sistem

1.6 Më datë 12/04/2021 me shkresën me Nr.Prot.681/2 dërguar nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara na është dërguar vendimi mbi ankesën tonë duke na njoftuar se: Pretendimi i ofertuesit SILVER SHPK nuk pranohet me arsyetimin se:

Kriteri në dokumentet e tenderit është përcaktuar për xhiron e realizuar në tre vitet e fundit 2017, 2018, 2019, vlera mesatare e të cilës të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të lotit.

Pra i njëjti komision i përberë në shumicë nga të njëjtet anëtarë kundërshton vendimin e tij të parë ku thuhet se: Kriteri i sipërcituar do të modifikohet si vijon:

Kopje të deklaratave të xhiros vjetore ose vërtetim nga administrata tatimore, për xhiron e realizuar në tre vitet e fundit financiare (2018,2019,2020), vlera e të cilës të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit.

Në arsyetimin e skualifikimit nga KVO në sistem thuhet Operatori ekonomik Silver SHPK nuk plotëson nenin 1, të seksionit 3.2, Kapaciteti ekonomik dhe financiar të Kriteve të vecanta të kualifikimit, pasi në momentin e hapjes së ofertave nuk arriti të provojë se ka kapacitete ekonomike financiare sa shuma e loteve 1 dhe 7 për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku pasi nga dokumentacioni i paraqitur në SPE, rezultojnë se mesatarja e xhiros së realizuar për periudhën e kërkuar është me e vogël se 40% e vlerës së shumës së fondeve limit (loti 1 dhe loti 7) për të cilët ka ofertuar.

Kurse në përgjigje të ankesës tonë nga KSHA thuhet Kriteri në dokumentet e tenderit është përcaktuar për xhiron e realizuar në tre vitet e fundit 2017, 2018, 2019, vlera mesatare e të cilës të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të lotit.

Na lind e drejta të mendojmë në rast se sipas KSHA: kriteri në dokumentet e tenderit është përcaktuar për xhiron e realizuar në tre vitet e fundit 2017, 2018, 2019, vlera mesatare e të cilës të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të lotit dhe Operatori Ekonomik ka dorezuar

Vertetim për xhiron e realizuar në tre vitet e fundit 2018, 2019, 2020, ku e gjeti KVO xhiron e vitit 2017 te Operatorit Ekonomik kur skualifikoi ofertën me pretendimin:

Operatori ekonomik Silver SHPK nuk plotëson nenpikën 1, të seksionit 3.2 ,Kapaciteti ekonomik dhe financiar te kriterete te vecanta te kualifikimit, pasi ne momentin e hapjes se ofertave nuk arriti te provoje se ka kapacitete ekonomike financiare sa shuma e loteve 1 dhe 7 per te cilat ka ofertuar, te marra se bashku pasi nga dokumentacioni i paraqitur ne SPE, rezulton se mesatarja e xhiros se realizuar per periudhen e kerkuar është me e vogel se 40% e vleres se shumes se fondeve limit (loti 1 dhe loti 7) per te cilet ka ofertuar.

Pra dy pergjigje te ndryshme për të njëjtën arsye skualifikimi.

Për autoritetin kontraktor është e domosdoshme dhe e rëndësishme të vërtetohet që një operator ekonomik plotëson kriteret e kërkuara, për sa kohë ato janë në përputhje dhe në përpjesëtim me përmasat dhe natyrën e objektit që prokurohet.

Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe është përgjegjësi e tij të përcaktojë kriteret që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Referuar legjislacionit në fuqi për prokurimin publik, vendosja e kriterete të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Ne nenin 46,pikal,germa c, te ligjit nr.9643,date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: 1) "Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese",1.c) gjendja ekonomike e financiare: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet ekonomike e financiare për të përmbushur kontratën, me anë të deklaratave bankare ose, kur nevojitet, nëpërmjet vërtetimit për sigurim ndaj rreziqeve profesionale, paraqitjes së bilanceve financiare ose të pjesëve të shkëputura nga bilancet, një deklaratë të xhiros së përgjithshme të shoqërisë dhe, në rast nevojë, të xhiros së realizua nga veprimtaritë e ngjashme me objektin e kontratës që do të prokurohet për një periudhë deri në 3 vitet e fundit financiare, kur ky informacion është i mundur.

Qe ne daten 02.02.2021 Vertetimi Per Xhiron e Tre Viteve te Fundit qe gjeneron sistemi per Ne është per vitet 2018,2019,2020 (bashkelidhur nje vertetim te gjeneruar nga sistemi).

Jemi skualifikuar sepse paskemi dorezuar xhiron, pasqyrat financiare, bilancin dhe kemi paguar detyrimet tona per vitin financiar 2020 ne Janar 2021 shumë kohë perpara hapjes se procedures ne fjale dhe kerkesa jone per modifikim te kriterit edhe pse është pranuar nuk merret ne konsiderate.

Sa më sipër, autoriteti kontraktor, duhet të udhëhiqet nga parimi i mirëpërdorimit të fondeve publike dhe përfitimi i një shërbimi me cilësi të mire dhe me çmim të ulët, si edhe nuk duhet të gjykojë në mënyrë sipërfaqësore e formale.

Për sa më lart sqaruar, Operatori Ekonomik Silver SHPK ka dorëzuar të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve para hapjes së ofertave dhe rrjedhimisht duhet të kualifikohet si oferte e suksesshme.

Për sa më sipër argumentuam, në zbatim të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar Nenit 63,pika 6, të LPP, VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar me Vendimin Nr. 402. date 13.05.2015, me Vendimin Nr.823,date 23.11.2016, me Vendimin Nr.797, date 29.12.2017.me Vendimin Nr.80 date 14.02.2018 , me Vendimin Nr.823.date 21.10.2020 dhe Ligjit Nr. 162/2020

Kualifikimin e ofertës së Operatorit Ekonomik Silver SHPK si ofertë që i përmbush të gjitha kriteret.

II.7. Nëpërmjet shkresës nr. 819 prot 27.04.2021 protokolluar me tonën me nr.621/2 prot datë 30.04.2021 me objekt “Dërgohet informacioni”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe kërkesës të operatorit ekonomik ankimues,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyen: *[...]1.5 Operatori ekonomik Silver SHPK ka derguar ankese qe mban Nr.Prot 22 me date 02/04/2021 prane ABP-se me ane te se ciles sqarojme shprehimisht si me poshte:*

Ne dokumentacionin e paraqitur ne SPE nga operatori ekonomik mesatarja e xhiros se 3 viteve te Fundit (2018,2019.2020) është 17,023,629 (shtatembedhjetë million e njezet e tre mijë e gjashtëqind e njezet e nente) Leke pasi shuma totale e xhiros vjetore e 3 viteve te fundit është 51,070,887 (pesedhjetë e nje million e shtatedhjetë mijë e teteqind e tetedhjetë e shtate) Leke.

Pra pjesetimi i shumës totale të xhiros vjetore të 3 viteve të fundit me numrin 3 na nxjerr rezultatin 17,023,629 (shtatembedhjetë million e njezet e tre mijë e gjashtëqind e njezet e nente) Leke Shuma e vlerës së fondeve limit të lotit 1 (23,283,310) dhe lotit 7 (18,175,160) është 41,458,470 (dyzet million e katerqind e pesedhjetë e tete mijë e katerqind e shtatedhjetë) Leke dhe rrjedhimisht 40% e kësaj vlere totale të fondeve limit të loti 1 dhe loti 7 del në vlerën 16,583,388 (gjashtembedhjetë milion e peseqind e tetedhjetë e tre mijë e treqind e tetedhjetë e tete) Leke.

Pra sipas perlllogaritjeve të bera nga ne dhe lehtesisht të verifikueshme nga ana juaj rezulton që mesatarja e xhiros se 3 viteve të fundit është me e madhe se 40% e vlerës së shumës së fondeve limit (loti 1 dhe loti 7) për të cilët kemi ofertuar (17,023,629 > 16,583,388)

Pra i jemi pergjigjur ekzaktesisht arsyetimit të skualifikimit të paraqitur nga ABP në sistem.

1.6 Më datë 12/04/2021 me shkresën me Nr.Prot.681/2 dërguar nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara na është dërguar vendimi mbi ankesën tonë duke na njoftuar se: Pretendimi i ofertuesit SILVER SHPK nuk pranohet me arsyetimin se:

Kriteri ne dokumentet e tenderit është përcaktuar për xhiron e realizuar në tre vitet e fundit 2017, 2018, 2019, vlera mesatare e të cilës të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të lotit.

Pra i njejti komision i perbere ne shumice nga te njejtet anetare kundershton vendimin e tij te pare ku thuhet se: Kriteri i sipercituar do te modifikohet si vijon:

Kopje te deklaratave te xhiros vjetore ose vertetim nga administrata tatimore, për xhiron e realizuar ne tre vitet e fundit financiare(2018,2019,2020), vlera e te ciles te jete jo me e vogel se 40% e vleres se fondit limit.

Ne arsyetimin e skualifikimit nga KVO ne sistem thuhet Operatori ekonomik Silver SHPK nuk plotëson nenpikën 1, të seksionit 3.2 ,Kapaciteti ekonomik dhe financiar te Kriteve te vecanta te kualifikimit, pasi ne momentin e hapjes se ofertave nuk arriti te provoje se ka kapacitete ekonomike financiare sa shuma e loteve 1 dhe 7 per te cilat ka ofertuar, te marra se bashku pasi nga dokumentacioni i paraqitur ne SPE, rezulton se mesatarja e xhiros se realizuar per periudhen e kerkuar është me e vogel se 40% e vleres se shumes se.[...]

III.1.1. Në dokumentet e tenderit Shtojca 8 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, parashikohet si më poshtë vijon:

3.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. *Kopje të deklaratave të xhiros vjetore ose vërtetim nga administrata tatimore, për xhiron e realizuar në tre vitet e fundit 2017, 2018, 2019, vlera mesatare e të cilës të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të lotit.*

III.1.2. Në dokumentet , parashikohet si më poshtë vijon:

Shënim: *Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare (nënpika 1 e seksionit 3.2, të kriteve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetet teknike (nënpikat 1, 3 dhe 4 të seksionit 3.3, të kriteve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Në këtë rast, operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të paraqesë një deklaratë ku të listohen dokumentet e paraqitura në përmbushje të kriteve kumulative për Lotin konkret. Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kriteve kumulative nuk plotëson kapacitetet ekonomike - financiare dhe kapacitetet teknike për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, do të skualifikohet nga të gjitha Lotet ku ka ofertuar.*

III.1.3 Nga verifikimi i kryer ngas sistemi i elektronik percaktohet se auroriteti kontraktor ka ndryshuar me ane te shtojces perkatese kriterin si me poshte vijon ne lotin 8:

- Për Lotin 1, Lotin 2, Lotin 3, Lotin 4, Lotin 5, Lotin 6, Lotin 7, Lotin 8, tek shtojca 8 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” senksioni 3.3 (kapaciteti teknik) pika 2:

ISHTE:

2. Operatori ekonomik duhet të provojë se disponon të paktën 1 (një) ambient, ku ushtron veprimtarinë e shërbimit dhe gatimit te ushqimit, për të cilin duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a) Dokumentacionin që vërteton pronësinë ose huapërdorjen ose qiramarrjen si më poshtë:
 - Dokumentacioni që vërteton pronësinë:
 - Certifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj ose kontrata e shitblerjes ose kontrata e dhurimit ose çdo dokument tjetër me anë të së cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.
 - Dokumentacioni që vërteton huapërdorjen:
 - Kontratë huaje.
 - Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira:
 - Kontratë qiraje.
 - a) Akt miratimi higjieno – sanitar për këtë ambient, lëshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj.
 - b) Certifikate për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin, lëshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj.
 - c) Operatori ekonomik duhet të deklarojë plotësimin e standardeve tekniko-teknologjike për ambientin ku ushtron veprimtarinë e shërbimit dhe gatimit te ushqimit.

BËHET:

2. Operatori ekonomik duhet te provojë se disponon të paktën 1 (një) ambient, ku ushtron veprimtarinë e shërbimit dhe gatimit te ushqimit, për të cilin duhet te paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a) Dokumentacionin që vërteton pronësinë ose huapërdorjen ose qiramarrjen si më poshtë:
 - Dokumentacioni që vërteton pronësinë:
 - Certifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj ose kontrata e shitblerjes ose kontrata e dhurimit ose çdo dokument tjetër me anë të së cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.
 - Dokumentacioni që vërteton huapërdorjen:
 - Kontratë huaje.
 - Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira:
 - Kontratë qiraje.
 - b) Certifikate për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin, lëshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj.
 - c) Operatori ekonomik duhet të deklarojë plotësimin e standardeve tekniko-teknologjike për ambientin ku ushtron veprimtarinë e shërbimit dhe gatimit te ushqimit.

Për Lotin 1, Lotin 2, Lotin 3, Lotin 4, Lotin 5, Lotin 6, Lotin 7, Lotin 8, tek Shtojca 8 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” senksioni 3.3 (kapaciteti teknik) pika 3:

ISHTE:

3. Operatori ekonomik duhet të disponojë minimumi 1 (një) mjet transporti frigoriferik, për transportin e produkteve ushqimore, në pronësi ose me qira, të vërtetuar me dokumentacionin përkatës, si më poshtë:
- Dokumentacioni që vërteton pronësinë:
 - Certifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj ose kontrata e shitblerjes/ose kontrata e dhurimit ose çdo dokument tjetër me anë të së cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.
 - Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira:
 - Kontratë qiraje.
 - a) leje qarkullimi,
 - b) certifikatë e kontrollit teknik të mjeteve rrugore,
 - c) policë për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve,
 - d) akt miratimi higjieno – sanitar.
 - e) Certificate për transport mallrash (e detyrueshme vetëm për mjetet me kapacitet transportues mbi 1,500 kg).

BËHET:

3. Operatori ekonomik duhet të disponojë minimumi 1 (një) mjet transporti frigoriferik, për transportin e produkteve ushqimore, në pronësi ose me qira, të vërtetuar me dokumentacionin përkatës, si më poshtë:
- Dokumentacioni që vërteton pronësinë:
 - Certifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj ose kontrata e shitblerjes/ose kontrata e dhurimit ose çdo dokument tjetër me anë të së cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.
 - Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira:
 - Kontratë qiraje.
 - a) leje qarkullimi,
 - b) certifikatë e kontrollit teknik të mjeteve rrugore,
 - c) policë për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve,
 - d) Certificate për transport mallrash (e detyrueshme vetëm për mjetet me kapacitet transportues mbi 1,500 kg).

Për Lotin 8: “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Repartin Ushtarak nr. 6620 (PU)” Rinas, Tirane me nr. REF-87336-02-16-2021, në zbatim të Vendimit nr. 442/2prot., datë 22.02 2021 të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, në organin qendror blerës ABP, tek Shtojca nr. 8 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” tek 3.2 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar” pika 1:

ISHTE:

1. Kopje të deklaratave të xhiros vjetore ose vërtetim nga administrata tatimore, për xhiron e realizuar në tre vitet e fundit 2017, 2018, 2019, vlera mesatare e të cilës të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të lotit.

BËHET:

1. *Kopje të deklaratave të xhiros vjetore ose vërtetim nga administrata tatimore, për xhiron e realizuar në tre vitet e fundit (2018, 2019, 2020), vlera mesatare e të cilës të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit.*

Afati kohor për dorëzimin dhe hapjen e ofertave, për të gjitha Lotet (Loti 1 deri Loti 8), shtyhet për në datën 16.03.2021 ora 12:00.

Hapja e ofertave do të bëhet në faqen zyrtare të internetit www.app.gov.al, si dhe pranë Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara, Ministria e Brendshme, Sheshi Skënderbej, nr. 3, Tiranë.

III.1.4 . Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 29, përcaktohet se: *Kontrata për punë/mall/shërbim e ndarë në lote Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit.*

III.1.5 Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike, rezulton se operatori ekonomik, në përmbushje të kriterit sa më sipër, kanë paraqitur dokumentacionin si më poshtë:

“Silver” ShPK

“Vërtetim per tre xhirot e fundit me nr. rendor T03656249, datë 04.03.2021 , nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë ku vërtetohet se kjo shoqëri ka raportuar të ardhura nga shitja e mallrave/shërbimeve, për vitin 2020 (34,379,164 lekë), për vitin 2019 (9,308,221 lekë), si dhe për vitin 2018 (7,383,502 lekë).

III.1.6. Në nenin 46, pika 1, gërma “c” të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”;c) gjendja ekonomike e financiare: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet ekonomike e financiare për të përmbushur kontratën, me anë të deklaratave bankare ose, kur nevojitet, nëpërmjet vërtetimit për sigurim ndaj rreziqeve profesionale, paraqitjes së bilanceve financiare ose të pjesëve të shkëputura nga bilancet, një deklaratë të xhiros së përgjithshme të shoqërisë dhe, në rast nevojë, të xhiros së realizuar nga veprimtaritë e ngjashme me objektin e kontratës që do të prokurohet për një periudhë deri në 3 vitet e fundit financiare, kur ky informacion është i mundur.”*

III.1.7 . Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 28, pika 4, gërma “a” dhe “b”, përcaktohet se:

“Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon:

a) kopje të certifikuara të një ose më shumë bilanceve, të paraqitura në autoritetet përkatëse: dhe/ose

b) kopje të deklaratave të xhiros vjetore. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufirin e ulët monetar, vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk mund të tejkalojë vlerën limit të kontratës që prokurohet. Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufirin e ulët monetar, vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës limit të kontratës që prokurohet”.

III.1.8. KPP gjykon se në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte pretendime në lidhje me kërkesën e mësipërme të autoritetit kontraktor *ne lidhje me xhiron e realizuar ne tre vitet e fundit perkatesisht (2017-2018-2019)* e ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës në lidhje me pretendimet e tij parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP, ku parashikohet se *“Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”.*

III.1.9. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

III.1.10. Komisioni i Prokurimit Publik vëren se autoriteti kontraktor ka përcaktuar qartë në DST tre vitet, për të cilat kërkohet dorëzimi i deklaratës për xhiron vjetore . Konkretisht autoriteti kontraktor ka kërkuar në kriterin e veçantë të kualifikimit dokument për tre vitet e fundit dhe ka cituar në kllapa vitet 2017, 2018, 2019. Ndërkohë referuar ankeses se paraqitur nga operatori ankimues vërehet se ka paraqitur ankese pranë autoritetit kontraktor në lidhje me ndryshimin e kriterit ne lotin 8 *“Kopje të deklaratave të xhiros vjetore ose vërtetim nga administrata tatimore, për xhiron e realizuar në tre vitet e fundit (2018, 2019, 2020), vlera mesatare e të cilës të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit, për të cilin autoriteti kontraktor e ka pranuar dhe ka bërë ndryshimet përkatëse. Ndërkohe për lotin 7 është kërkuar kopje e deklaratave të xhiros vjetore për vitet (2017-2018-2020) për të cilën operatori ekonomik ka dorëzuar dokumentacionin përkatës të sipërcituar. Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues vërtetim për xhiron vjetore për tre vitet e fundit 2017,2018,2019 KPP konstaton, se operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar sipas autoritetit për vitet përkatëse dhe për këtë arsye nuk përmbush kriterin e përcaktuar.*

Sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Silver” SHPK nuk qëndrojnë..

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, , njëzëri

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Silver” SHPK për procedurën e prokurimit, *Procedurë e Hapur*”, me nr. REF-87331-02-16-2021 me objekt Loti 7 “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Repartin Ushtarak nr. 1010”, Vau i Dejës-Shkodër, me fond të marrëveshjes kuadër: 18,175,160 (tetëmbëdhjetë milion e njëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë) Lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 18.03.2021 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit të sipërcituar.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 621 Protokolli Datë 16.04.2021

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaid Myzyri